VENDIM
Nr. 72, datë 17.11.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Marsida Xhaferllari, kryesuese;
Fiona Papajorgji, anëtare;
Sonila Bejtja, anëtare;
Ilir Toska, anëtar;
Genti Ibrahimi, anëtar;
Marjana Semini, anëtare;
Sandër Beci, anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 17.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (V) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA "Vega" sh.a., e përfaqësuar nga administratorja Artenida Dervishi dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës, avokat Erjon Kanxheri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Zyra e Përmbarimit privat "Jus" sh.p.k.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Prishja/shfuqizimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 44, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim kërkesën e kërkueses, shoqërisë "Vega" sh.a. *(kërkuesja)*, për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe konstatoi mungesën e mendimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë *(MIE)* dhe Zyrës së Përmbarimit Privat "Jus" sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja në datën 10.6.2011 ka lidhur me Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës *(MTI)* "Marrëveshje për caktimin dhe rinovimin e kontratës për ndërtimin e ndërtesës së terminalit të trageteve Durrës dhe infrastrukturës së kantierit lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe SCT d.d. më 6 maj 2008". Sipas pikës 20.6. të këtij akti, përveçse kur zgjidhet në mënyrë miqësore, çdo mosmarrëveshje zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar, sipas rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë *(ICC)*.

2. Për shkak se mes palëve kanë lindur mosmarrëveshje për zbatimin e kontratës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC-së. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, ka vendosur pjesërisht në favor të kërkueses.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 97, datë 3.5.2017, ka vendosur njohjen dhe dhënien fuqi ligjore vendimit të ICC-së nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, duke lëshuar edhe urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim. Për rrjedhojë, kërkuesja i është drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor privat për ekzekutimin e tij. Në datën 18.12.2017 MTI-ja ka ekzekutuar pagesën e detyrimeve dhe kostove procedurale, por pa përfshirë interesat për vonesën. Emërtimi i MTI-së ka ndryshuar në MIE. Për këtë qëllim, në këtë vendim emrat e institucioneve janë përdorur në përkëmbim të njëri-tjetrit.

4. Në datën 11.12.2018 MIE-ja ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, si dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit privat. Me vendimin nr. 10718, datë 26.12.2018, ajo gjykatë ka vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vijim, ajo gjykatë, me vendimin nr. 1228, datë 29.6.2020, ka vendosur pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesja dhe Zyra e Përmbarimit Privat "Jus" sh.p.k.

5. Me vendimin nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Mbi rekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Në datën 3.6.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.6.2025. Në datën 30.7.2025 një gjyqtar, pas njohjes me aktet, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me anë të vendimit nr. 19, datë 30.7.2025, ka vendosur pranimin e kësaj kërkese. Kolegji i Gjykatës (pas plotësimit me anëtarin zëvendësues), në datën 31.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 29.10.2025 kërkuesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual i paraqitur në datën 3.6.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja,*** mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kufijtë ligjorë rishqyrtues. Ajo gjykatë ka shqyrtuar e vlerësuar prova dhe fakte, të cilat janë vlerësuar dhe arsyetuar nga gjykatat më të ulëta dhe asnjë palë nuk ka pasur pretendime. Rekursi i referohet interpretimit të provave dhe jo shkeljeve ligjore procedurale ose materiale dhe, si i tillë, nuk duhet të ishte bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Është pikërisht ky roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, e cila nuk ka gjetur elemente të natyrës ligjore, por ka bërë një analizë të mirëfilltë fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin procedural.

8.2. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar*, pasi Gjykata e Lartë ka rishqyrtuar themelin e çështjes tashmë të gjykuar nga gjykata e arbitrazhit. Dispozitivi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit është i qartë dhe i vetëzbatueshëm, dhe asnjë gjykatë nuk mund të ushtrojë kompetencë për të interpretuar rrethanat faktike ose dokumentet kontraktuale mbi të cilat është mbështetur vendimi. Për më tepër, ajo ka kërkuar verifikimin e metodologjisë së ndjekur nga gjykata e arbitrazhit për llogaritjen e detyrimit financiar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka kryer një shqyrtim të përmbajtjes së kontratës, e cila përbënte objekt të

drejtpërdrejtë të procesit të arbitrazhit dhe është analizuar nga kjo e fundit në kuadër të kompetencës së saj ekskluzive. Ndërkohë që gjykimi ka në thelb procedurat e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, në të cilat nuk lejohet rishqyrtimi i themelit të detyrimit ose përcaktimi i masës së tij. Në rastin konkret, orientimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, një dispozitë ligjore urdhëruese, e cila në mënyrë eksplicite ndalon shqyrtimin, vlerësimin ose analizën e një titulli ekzekutiv (vendim gjyqësor ose arbitrazhi) për fakte të mëhershme se dhënia e vendimit.

8.3. *Gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* për shkak se Gjykata e Lartë ka vepruar jashtë afateve ligjore për shqyrtimin e rekursit, duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 60 të ligjit nr. 49/2012, pasi vendimi është marrë në datën 19.2.2025, ndërkohë që rekursi është paraqitur në datën 11.12.2023.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Në datën 29.10.2025 kërkuesja që ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, nëpërmjet administratorit, ka paraqitur kërkesë, me objekt: "Heqje dorë nga kërkesa", në të cilën ka parashtruar se: *"Në zbatim të së drejtës së kërkueses për disponimin mbi kërkesën e paraqitur sipas nenit 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, kërkuesja shoqëria "Vega" sh.a., ju drejtohet, duke kërkuar: Heqjen dorë nga kërkesa e shoqërisë "Vega" sh.a. regjistruar pranë Gjykatës Kushtetuese më 10.6.2025, nr. Regj. Them., 6 (V), me objekt: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Prishja/shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit."*. Kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 29.10.2025 dhe u është komunikuar të gjitha palëve pjesëmarrëse në gjykim/subjekteve të interesuara, të cilat nuk kanë paraqitur prapësime në lidhje me të.

10. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenit 71, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, përfshihen edhe personat juridikë, sikurse shoqëria tregtare në këtë gjykim. Ndërsa neni 31/b i ligjit nr. 8577/2000 parashikon të drejtën e kërkuesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Heqja dorë nga kërkesa nuk pranohet kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuesit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

11. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata evidenton se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkuesit i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky i fundit, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik.

12. Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet të analizojë nëse shqyrtimi i çështjes konkrete mbart interes publik, në kuptimin që të zbatohet rregulli përjashtimor i parimit të disponibilitetit. Nga përmbajtja e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor, në të cilin kërkuesja ka qenë palë ndërgjyqëse në cilësinë e palës së paditur. Kërkuesja ka pretenduar se asaj i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

13. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkueses në këtë rast janë të

lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetuese dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI**:**

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.11.2025.

Shpallur më 26.11.2025.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini